

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-186/11

Prishtinë, 22 qershor 2012

Në çështjen e

D.L.

Paraqitësi i ankesës

I përfaqësuar nga

M.L.

Paraqitësja e kërkesës

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga Anne Kerber, kryetare e kolegjit, Elka Filcheva-Ermenkova dhe Sylejman Nuredini, gjyqtarë, duke vendosur me ankesën ndaj vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/61/2010 (lëndët janë regjistruar në AKP me numrat KPA08476 dhe KPA08477), të datës 26 shkurt 2010, pas seancës së mbajtur me 22 qershor 2012, mori këtë

AKTGJYKIM

- 1- Hedhet poshtë si e vonuar ankesa e D.L. kundër vendimit KPCC/D/A/61/2010, të datës 25 shkurt 2010.

- 2- Vërtetohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore i Kosovës KPCC/D/A/61/2010, i datës 25 shkurt 2010, që referohet për lëndët e regjistruara me numrat KPA08476 dhe KPA08477.
- 3- Obligohet pala ankuese që të paguaj shpenzimet e procedurës në shumën prej 60 € (gjashtëdhjetë euro), të cilat duhet të paguhen në Buxhetin e Kosovës brenda afatit prej 90 (nëntëdhjetë) ditësh nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimit nën kërcënimin e përmbartimit të detyrueshëm.

Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:

Më 11 janar 2007, M.L., duke vepruar si anëtare e familjes së ngushtë në emër të vjehrrit të ndjerë ka paraqitur një kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP), ku ka kërkuar që të njihet si pronare e ngastrave të ndryshme të tokës të përvetësuar me anë të trashëgimisë dhe ka kërkuar ri-posedimin e tyre. Ajo ka sqaruar se këto ngastra i përkisnin vjehrrit të saj të ndjerë M.L.. Ajo ka thënë se prona ishte uzurpuar si rezultat i rrethanave të vitit të viteve 1998/1999 në Kosovë dhe se datat e humbjes ishte 12 qershori 1999.

Për të mbështetur kërkesën e saj, ajo ka paraqitur në AKM dokumentet në vijim:

- Certifikatën e saj të martesës
- Fletën poseduese nr. 38 të lëshuar nga Zyra Kadastrale Podujevës për Komunën Kadastrale të Peranit me 8 tetor 1997.

Fleta poseduese nr. 38 ka treguar në mesin e ngastrave tjera M.L. ishte pronar i ngastrave të kërkuara në vijim:

Numri i ankesës dhe lëndës së AKP-së	Të dhënat lidhur me ngastrën e kërkuar
GSK-KPA-A-186/11 (KPA08476)	Ngastra nr. 526, në vendin e quajtur “Labske Njive-Kod R”, Peran, arë e klasës 2 me sipërfaqe prej 5 ari e 81 m ²
GSK-KPA-A-187/11 (KPA08477)	Ngastra nr. 616, në vendin e quajtur “Iznad Reke-Obrania\A”, Peran, arë e klasës 1 me sipërfaqe prej 40 ari e 63 m ²

Me 25 shkurt 2010, Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës (KKPK) me vendimin e tij KPCC/D/A/61/2010 e ka hedhur poshtë kërkesën. Sipas nr. 30 të vendimit të tij, Komisioni ka

theksuar se paraqitësja e kërkesa nuk ishte anëtare e familjes së ngushtë të bartësit të së drejtës pronësore. Ndonëse paraqitësja e kërkesës është kontaktuar disa herë nga AKP-ja, ajo nuk ka paraqitur autorizimin e nevojshëm të anëtarit të familjes së ngushtë të bartësit të së drejtës pronësore. Prandaj, KKPK-ja ka deklaruar se paraqitësja e kërkesës nuk ka arritur që të dëshmojë kapacitetin e saj për të paraqitur kërrlës në emër të bartësit të së drejtës pronësore (neni 5.2 i Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 të ndryshuar me Ligin nr. 03/L-079).

Në fund të vendimit, KKPK-ja ka sqaruar se ankesa kundër vendimit duhej të paraqitej brenda 30 (tridhjetë) ditë ve nga njoftimi i palëve.

Vendimi i është dorëzuar paraqitëses së kërkesë me 12 janar 2011. Me 11 tetor 2011, paraqitësja e kërkesës ka paraqitur pesë ankesa identike në Gjykatën Supreme, secila nga to kishte të bënte me një kërkesë të veçantë, ky dy nga ankesat kishin të bëjnë me kërkesat të cilat janë çështje e këtij vendimi. Ankesat tjera kishin të bënin me katër kërkesat të cilat ishin vendosur nga KKPJ-a në një vendim tjetër.

Paraqitësja e kërkesës tani kërkon që Gjykatat Supreme t'i jap të birit të saj D.L. të drejtën e posedimit të pronës së regjistruar si pronë M.L. dhe që ndodhe tnë komunën kadastrale të Peranës.

Paraqitësja e kërkesës ka sqaruar se vjehri i saj i ndjerë, M.L., kishte vdekur me 11 dhjetor 1989. Pala ankuese më tej ka sqaruar se bashkëshorti i saj, J.L., kishte vdekur me 29 gusht. Pas vdekjes së vjehrrit, procedura e trashëgimisë ishte kryer dhe i biri i saj, D.L., ishte shpallur si njëri prej trashëgimtarëve. Në ankesës e saj ajo për më tepër ka deklaruar se nuk do të paraqiste në emër të saj ose në emër të vjehrrit të saj, por në emër të të birit , D.L., i cili ishte pasardhës ligjor i bartësit të së drejtës pronësore, gjyshit të tij M.L.. Pala ankuese më tej ka cekur pa ndonjë sqarim të mëtutjeshëm se i biri i saj nuk ka qenë në gjendje që të paraqes kërkesë në emër të tij në kohën kur është dashur të paraqitej kërkesa. Ajo ka thënë se e kishte marrë autorizimin nga i biri i saj para se ajo të paraqiste kërkesën. Për të mbështetur këtë pohim, ajo ia ka paraqitur Gjykatës Supreme një autorizim, që cek se D.L. e kishte autorizuar paraqitësin e kërkesës për t'i paraqitur kërkesat – parashtrrojë ankesat lidhur me vendimin e AKP-së në lëndët KPA08466, KPA08469, KPA08471, KPA08473, KPA08476 dhe KPA08477 si dhe për tërë pronën e regjistruar në fletën poseduese “Nr. 33”. Paraqitësja e kërkesës ishte autorizuar që të ndër marrë të gjitha veprimet juridike në procedurë. Autorizimi ishte lëshuar në Beograd, i datës tetor 2011, nërsa nënshkrimi është i palexueshëm. Nënshkrimi është certifikuar me nr. 13318/2011 nga gjykatat Komunale e Novi Pazarit me 10 qershor2011.

Megjithatë, nuk është dhënë ndonjë arsye se përse ankesa ishte paraqitur ankesë nëntë muaj pasi që i ishte dorëzuara vendimi.

Gjykatat Supreme i ka bashkuar ankesat sipas nenit. 408.1 të LPK-së. Pala/palët, faktet dhe çështjet ligjore janë të njëjta, vetëm ngastrat janë të ndryshme. Në këtë mënyrë, bashkimi i ankesave siguron efikasitetin e lëndës. Po ashtu, bashkimi zvogëlon shpenzimet e procedurës. Lënda GSK-KPA-A-187 (KPA08477) bashkohen me lëndën GSK-KPA-A-186 (KPA08476).

Arsyetim ligjor:

Ankesat janë të papranueshme. Ato duhet të refuzohen si të vonuara

Neni 12.1 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 parasheh: *“Brenda tridhjetë (30) ditëve nga njoftimi i palëve nga Agjencia Kosovare e Pronës për vendimin e Komisionit mbi ankesën, pala mund të paraqesë ankesë ndaj vendimit të tillë në Gjykatën Supreme të Kosovës përmes Sekretarisë ekzekutive të Agjencisë Kosovare të Pronës”.*

Megjithatë, D.L. nuk ka paraqitur ankesë brenda këtij afati. Paraqitësit të kërkesës, përfaqësuesit të tij i është dorëzuar vendimi me 12 janar 2011. Ky dorëzim që i është bërë përfaqësues së tij duhet të konsiderohet si dorëzim për palën ankuese (shiko nenin 107.1 të LPK-së). Megjithatë, ai e kishte paraqitur kërkesën e tij vetëm me 11 tetor 2011. Kjo tejkalon për së tepërmi afatin. Pala ankuese nuk e shpjegon këtë vonesë. Gjykatat po ashtu nuk sheh ndonjë arsye e cila to të mund të justifikonte ankesën e vonuar. Posaçërisht pala anuse është njoftuar shprehimisht për afatin me tekst në fund të vendimit të KKKP-së.

Në këtë mënyrë, nuk ishte e nevojshme që të vendoset nëse – pasi që pala ankuese nuk ka qenë palë në procedurë para KKKP-së – ai kishte të drejtë të paraqiste ankesë (shih nenin 12.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079: ”Brenda tridhjetë (30) ditëve nga njoftimi i palëve nga Agjencia Kosovare e Pronës për vendimin e Komisionit mbi ankesën, pala mund të paraqesë ankesë ndaj vendimit të tillë [..]”).

Shpenzimet e procedurës:

Në përputhje me Shtojcën III, nenin 8.4 të Urdhërësës Administrative (UA) 2007/5 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, palët përjashtohen prej shpenzimeve të procedurës para Sekretarisë Ekzekutive dhe Komisionit.

Ndërkaq një përjashtim i tillë nuk parashikohet në procedurën para Kolegjit të Apelit. Rrjedhimisht, regjimi normal i shpenzimeve gjyqësore siç parashihet me Ligjin mbi Taksat Gjyqësore (Gazeta Zyrtare e KSAK, 3 tetor 1987) dhe sipas UA nr. 2008/2 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës mbi Unifikimin e Taksave Gjyqësore, zbatohet ndaj procedurës së zhvilluar para Kolegjit të Apelit.

Prandaj, shpenzimet gjyqësore si në vijim aplikohen në procedurën e tanishme të ankesës:

- Taksa nga tarifa gjyqësore për paraqitjen e ankesës (Neni 10.11 i UA 2008/2): 30 €
- Taksa nga tarifa gjyqësore për marrjen e aktgjykimit (Nenet 10.21 dhe 10.1 të UA 2008/2), duke pas parasysh se vlera e pronës në fjalë me arsye mund të vlerësohet në 5.000€ : 30€ (gjysmë pjesa e tarifës sipas numrit të tarifës 10.1, por jo më shumë se 30 €).

Këto tarifa gjyqësore duhet të merren përsipër nga pala ankuese që ka humbur rastin. Në përputhje me nenin 46 të Ligjit mbi Shpenzimet Gjyqësore, afati për pagesën e taksave në fjalë nga personi i cili ka vendqëndrim ose vendbanim jashtë vendit nuk mund të jetë më i shkurtër se 30 ditë e më i gjatë se 90 ditë. Gjykata vendos që në rastin tanishëm tarifat gjyqësore duhet të paguhet nga pala ankuese brenda 90 ditëve nga dita e dorëzimit të aktgjykimit. Neni 47.3 parasheh së në rast se pala nuk i paguan taksat brenda afatit të dhënë, pala duhet të paguajë një gjobë. Nëse pala nuk i paguan taksat brenda afatit të dhënë atëherë bëhet zbatimi i detyrueshëm i pagesës.

Këshillë juridike

Sipas nenit 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet me mjeteve të rregullta dhe të jashtëzakonshme juridike.

Anne Kerber, Kryetare e Kolegjit, EULEX

Elka Filcheva-Ermenkova, Gjyqtare e EULEX-it

Sylejman Nuredini, Gjyqtar

Urs Nufer, Referent i EULEX-it